

VENDIM
Nr.702, datë 11.10.2006

PËR MIRATIMIN E STEMËS SË UNIVERSITETIT “ALEKSANDËR MOISIU”, Durrës

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 44 të ligjit nr.8461, datë 25.2.1999 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e stemës së universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës, e cila të jetë sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

LIDHJA NR.1
ELEMENTET PËRBËRËSE TË STEMËS SË UNIVERSITETIT “ALEKSANDËR MOISIU”

Stema është në formë rrethore. Ajo përmban tre rrathë ekocentrikë. Trashësia e vijës së dy rrathëve më të vegjël është e njëjtë dhe sa $\frac{1}{3}$ e trashësisë së rrethit më të madh. Distanca ndërmjet rrethit më të vogël dhe atij të mesit është 5 herë sa distanca midis rrethit më të madh dhe atij të mesit. Në fusha midis dy rrathëve më të vegjël është e ngjyrosur me gradient radial, që nis me ngjyrë portokalli dhe mbaron me ngjyrën e bardhë. Në pjesën e poshtme të kësaj hapësire, me germa të mëdha me llojin e germave “Trajan Pro”, madhësi 40 pt, stil bold dhe ngjyrë të zezë, shkruhet fjala:

Durrës,

ndërsa në pjesën e sipërme me të njëjtin stil shkruhen fjalët:

Universiteti “Aleksandër Moisiu”

Fusha e rrethit të vogël është e ngjyrosur me gradient linear me kënd 45 gradë, që nis me ngjyrën blu dhe mbaron me ngjyrën e bardhë. Në këtë fushë janë vendosur dy kolona antike vertikale dhe paralele me njëra-tjetrën mbi një libër të hapur, dhe që ndërpriten nga një e tretë, duke formuar imazhin e germës “U”. Kolona vertikale e djathtë pasohet nga një velë, e cila së bashku me kolonën e djathtë formon imazhin e germës “D”. Kolonat, libri dhe vela janë konturuar nga vija të zeza me hije portokalli. Libri dhe kolonat kanë ngjyrë të bardhë, ndërsa vela skajet i ka me gradient linear nga e zeza në të bardhë, ndërsa në mes ka një shirit me ngjyrë portokalli të çelët.

